

Hapet thirrja për aplikime për bursa për stafin akademik me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës në kuadër të programit Erasmus + në Universitetin Politeknik Santarem, Portugali.

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për trajnim në Universitetin Politeknik Santarem në Portugali, për stafin akademik me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës, për semestrin e dytë të vitit akademik 2022 - 2023.

<https://www.ipsantarem.pt/>

Llojet e mobilitetit:

- Shkëmbimin e stafit akademik me kohë të plotë për trajnim;
Stafi do të marrë pjesë në Javën Ndërkombëtare me temë: “Inteligjenca artificiale dhe impakti i saj në jetën akademike”, e cila do të zhvillohet në datat 15-19 maj 2023.

Fushat e shkëmbimit:

- Informatikë Ekonomike;
- Informatikë.

Kohëzgjatja e bursave:

- 5 ditë +2 ditët e udhëtimit;

Bursat përfshijnë:

-Kompensimin për stafin (160 EUR në ditë për stafin);
-Kostot e udhëtimit 360 Euro (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik me kohë të plotë:

- CV + Lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Vetëdeklarim nëse keni kryer ose jo më parë mobilitet Erasmus+ (nëse po, ku);
- Plani i mobilitetit për trajnim*;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Trajnim klikoni në adresën:

https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Mobility_Agreement_Training_outgoing-1.docx

*Plani i Mobilitetit është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat, i cili është Koordinatori Institucional Erasmus +.

Afati për aplikim: **27 Shkurt 2023**

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!